



# BULETINI I LAJMEVE TË SIGURISË KIBERNETIKE

Qershor 2020



**Albanian Cyber Academy**  
4-th Edition  
22 June - 3 July 2020

 <b>17</b> 11 International speakers, 6 local experts	 <b>600+</b> participants in 2 weeks, <b>65% women</b>
 <b>2</b> hands on sessions conducted	

Edicioni i katërt i Albanian Cyber Academy tejkaloi pritshmëritë e të gjithë pjesëmarrësve dhe partnerëve të eventit

AKCESK organizoi më 22 qershor - 3 korrik 2020 edicionin e katërt të Albanian Cyber Academy (ACA4). Duke respektuar masat e vendosura për shkak të pandemisë globale Covid-19 aktivitetet e ACA4 u zhvilluan në internet.

Qëllimi i këtij aktiviteti mbarëkombëtar ishte rritja e aftësive dhe thellimi i njohurive të profesionistëve të sigurisë kibernetike dhe studentëve të rinj të talentuar të fushës. Këtë vit, 11 spikera ndërkombëtarë mes të cilëve Ramsés Gallego, Erdal Ozkaya, Mitko Bogdanoski, Ljubica Pendaroska, Ivica Simonovski, Predrag Pale, Metodi Hadji Janev, Marjan Stoilkovski, Almerindo Graziano dhe Marwan Ben Rached, si dhe 6 ekspertë kombëtarë Ogerta Elezaj, Eralda Dhama (Gjika), Elda Kuka, Elio Pashaj, Sokol Qeraxhiu e Bruno Sholla, shkëmbyen ekspertizën e tyre me 600+ pjesëmarrës në aktivitetet dhe me më shumë se 60 pjesëmarrës unikë në ditë.

Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike organizoi një trajnim për ngritjen e kapaciteteve (Cyber Drill) të CSIRT sektoriale. Trajnimi u përqëndrua jo vetëm në masat e sigurisë të aplikueshme nga infrastrukurat kritike dhe të rëndësishme të informacionit në nivel kombëtar, por edhe në adresimin e kërcënimeve dhe inovacioneve në fushën e Sigurisë Kibernetike që prekin këto infrastrukura, në mënyrë që të rritet niveli i sigurisë kibernetike në nivel kombëtar. Pjesë e kësaj sfide ishin operatorët publikë dhe privatë që administrojnë infrastrukura informacioni kritike dhe të rëndësishme, duke filluar nga operatori më i madh publik që administron shumicën e infrastrukturës qeveritare deri në ato private, përfshirë bankat e nivelit të dytë.

Dita e Grand Finale ishte një sukses i vërtetë dhe një provë që studentët e rinj të talentuar kanë fuqinë të transformojnë mënyrën se si funksionon bota virtuale.

## PËRMBAJTJA:

- Albanian Cyber Academy 4<sup>th</sup> Edition
- Covid-19 dhe sulmet kibernetike
- Sulmet ndaj Machine Learning
- 43% e sulmeve kibernetike targetojnë biznesin e vogël



## COVID-19, më shumë se një virus

Që nga fillimi i pandemisë së COVID-19, FBI raportoi një rritje prej 300% të krimeve të kibernetike. Sikur pandemia të mos mjaftonte, hakerat shfrytëzuan mundësinë për të sulmuar rrjetet e cënueshme, tekta puna e zyrës u transferua në shtëpi.

<https://www.varonis.com/blog/cybersecurity-statistics/>



## Sjellja e sistemeve të *machine learning* mund të manipulohet, me pasoja potenciale shkatërruese

Machine learning është bërë një pjesë integrale e shumë prej aplikacioneve që përdorim çdo ditë - nga njohja biometrike në smartphone deri te funksioni i njohjes së zërit të Alexa e filtrat e spamit në postat elektronike. Por përhapja e machine learning ka nxitur sulme kundërshtarë, një lloj i shfrytëzimeve që manipulojnë sjelljen e algoritmeve duke u siguruar atyre të dhëna hyrëse.

<https://portswigger.net/daily-swig/adversarial-attacks-against-machine-learning-systems-everything-you-need-to-know>

## 43% e sulmeve kibernetike targetojnë biznesin e vogël

62% e tyre u prekën nga sulmet phishing & social engineering  
59% e këtyre bizneseve përjetuan kode malicious dhe 51% sulme Denial of Service

<https://www.cybintsolutions.com/cyber-security-facts-stats/>